



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPÇTINA VITINA

Pranuar - Prënijena Me Dana 02-02-2015			
Nr i organit Org.broj	Nutritshëm Prilog	Rshinës Vrasim	
01-013/114			



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 36 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 30 janar 2015, aprovon këtë:

**V E N D I M**  
**PËR SHPALLJEN ME INTERES PUBLIK PARCELAT KADASTRALE NR. 1008-0,**  
**NR. 1009-0, NR 1012-2 DHE NR.1013-0 NË ZK BEGUNCË**

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, SHPALLË me interes publik parcelat kadastrale me nr.1008-0 me sipërfaqe 468m<sup>2</sup>, parcelën me nr.1009-0 me sipërfaqe 1983 m<sup>2</sup>, nr 1012-2 me sipërfaqe 1121m<sup>2</sup> dhe parcelën me nr 1013-0 me sipërfaqe 1608m<sup>2</sup> në Zonën Kadastrale Beguncë me qëllim të ndërtimit të objekteve me rëndësi të domosdoshme dhe funksionale për realizimin e interesit të përgjithshëm publik për çështje të komunës.

Neni 2

Parcelat Kadastrale të lartshënuara të shpallura interes i publik nga neni 1 i këtij Vendimi, në Zonën Kadastrale në Beguncë do të shërbejnë për ndërtimin e objektit të shkollës fillore në Beguncë.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe kopja (skica) e planit për parcelat të cilat shpallen interes publik dhe pastaj do të shpronësohen.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe zhvillim të Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit,
2. Drejtorisë për Kadastër
3. Drejtorisë për Financa dhe
4. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT  
Naim Pira

